

NGJITËS & RRAFSHUES



BONDEX

Ngjyra	Paketimi	Konsumi si ngjitës	Konsumi si rrafshues
E bardhë, Gri	25 Kg	4-5kg/m ²	2-3kg/m ²

PËRSHKRIM

Produkt ngjits dhe rrafshues për pllakat e izolimit termik, EPS, XPS dhe lësh guri, për fasadë dhe xokolaturë. I përforcuar me fibra. Gëzon aftësi shumë të mira në punim dhe rezistencë të lartë kundra lagështirës. Trashësia maksimale e shtresës për rrafshim deri në 5 mm dhe për ngjitje deri në 30 mm.

FUSHA E APLIKIMIT

Për ngjitjen dhe rrafshimin e të gjitha tipeve të pllakave të izolimit termik, për veshje fasadash dhe xokolaturash. Për ngjitje panelesh mbi mure tulle (të kuqe), tulla termike, mure të përziera apo mure guri, betone, mbi suva të reja dhe të vjetra. Realizimi i sistemeve të izolimit termik kapot. I përshatshëm dhe për përfortimin e bazamenteve minerale për veshje të mëvonshme dekorative.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT


Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhur, vajra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Për bazamente që nuk janë të qëndrueshëm është e domosdoshme vendosja e kunjave fiksuese. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë, në kushte normale temperaturash (20°C).

PËR NGJITJE

Përzieni me një përzierës elektrik 6-6.5 litra ujë me Bondex në një enë të pastër, deri sa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Aplikoni produktin me mallë mbi pllakën izoluese në një trashësi prej 30mm duke zënë rreth 45% të pllakës me ngjitës me metodën me topa dhe shirita. Përpara nivelimit të sipërfaqes me kollë vendosni kunjat fiksuese në varësi të pllakës së vendosur 5-6 kunjat/m².





PËR RRAFSHIM

Aplikoni produktin me mallë mbi pllakën izoluese në një trashësi prej 5 mm. Ashtu në gjendje të freskët aplikoni rrjetën përforcuese në mënyrë që të zhytet në ngjitës. Në kënde apo në vëndet e bashkimit në dyer apo dritare është e nevojshme që të aplikohet dy herë rrjeta përforcuese. Temperaturat optimale të punimit janë nga 5°C deri në 35°C. Për veshjet e mëvonshme është e rëndësishme që bazamenti të ketë arritur maturimin në tharje rreth 5-7 ditë kjo varet nga kushtet atmosferike.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	pH i perzierjes: >12
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350kg	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Ngjyra: E bardhë, Gri	Koha e pritjes për bojën: 7 ditë
Kokrrizimi: 0.7 mm	Koef i konduktivitetit termik (λ 10,dry): 0,52 W/Mkmm ²
Konsumi si ngjitës: 4-5 kg/m ²	Forca ngjitëse ne beton pas 28 ditësh: 1.7N/mm2
Konsumi si rrafshues: 2-3 kg/m ²	Rezistenca në shtypje: 16.1 N/mm2
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	Forca ngjitëse në EPS: 144 kPa
Koha e Magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	Absorbimi i ujit: W2
Masa Vëllimore: 1.6 – 1.7 gr/cm3	Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa A1
Ujë për përzierjen: 6-6.5 litra ujë për 25 kg	



KUJDES! Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund të ndryshojnë karakteristikat e punimit të produktit (ngadalsim ose përsheptim në tharje të produktit). Mos e përdorni në:

- Suporte druri,metali, PVC apo sipërfaqe të tjera jo me bazë çimento.
- Në ambiente ku ka lagështirë të vazhdueshme,
- Suporte që karakterizohen nga vibrime të paqëndrueshme.
- Në temperatura të larta, të ulëta, me erë të fortë.